

STATUT AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“QEPARO ENERGJI” Sh.p.k

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare”, ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR”, sot me date 23 Nentor 2023 me vullnetin e lire e te plote vendosem te krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “**QEPARO ENERGJI**” sh.p.k, me kete permbajtje,

I.-DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 23.11.2023 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjistacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi, ka perpiluar dhe nenshkruar statutin e Shoqerise si me poshte vijon :

Neni 1-Forma

Shoqeria “**QEPARO ENERGJI**” sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjsi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjistacioni ne fuqi.
Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjistacionin shqiptare dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruesit e tij, çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjistacioni shqiptare.

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar “**QEPARO ENERGJI**” Sh.p.k, krijohet nga ortaket

- **Hamit Aliu**, Nenshtetas i Repubikes se Maqedonise se veriut i identifikuar me Pasaport Nr.K1101347, i biri Sulejman, i datelindjes 27.02.1951, Lindur ne Tetov, Rruga Murat Bjaftjari, 60/A Tetov.
- **Zulfi Osmani**, Nenshtetas i Repubikes se Maqedonise se veriut i identifikuar me Pasaport Nr.N0244641, i biri Memet , i datelindjes 14.01.1969, Lindur ne Poraj, Tetov.

Neni 2 – Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “**QEPARO ENERGJI**” Sh.p.k.

Neni 3 – Selia

- Shoqeria “**QEPARO ENERGJI**” sh.p.k, me seli ne adresen: Lagjja 10, Kenedi Sport, Pallati 2, Zona kadastrale 8651, Korçe.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10 (dhjete) vjet. Ky afat mund te zgjatet me vendim te ortakeve te saj themelues ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

II.-OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise “**QEPARO ENERGJI**” sh.p.k, do te jete kryesishte : Ne fushen e Prodhimit dhe shitjes se energjis elektrike. Import eksport mallra e pajisje te teknologjise ne fushen energjitikes etj, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen, dhe menaxhimin e centraleve me impjante fotovoltaike e forma te tjera te prodhimt te energjise. Import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme elektrike. Ndertim dhe rikonstruksion kabinash te ndryshme TU, TM, TL. Furnizim dhe instalime paisjesh nga HEC-e dhe vepra te tjera industriale si : Turbina, lopatapune, transformatore, vinxha, nyje lidhese te ndryshme etj. Impiante ngrohes dhe ftohes ne vepra te ndryshme industriale. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



Neni 6

Shoqëria ka të drejtë të shtojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Ortakëve të saj.

Neni 7

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të krijojë filial, degë e përfaqësi brenda e jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendëve ku do të ushtrojë veprimtarinë.

Neni 8

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin duke u mbështetur në parimet e likuiditetit.

Për detyrimet e veta Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj.

III-MJETET E SHOQËRISË

Neni 9

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është në vlerën **100 000 (Njëqindmijë) Leke**. Kapitali i shoqërisë është ndarë në një kuotë sipas pjesëmarrjes në përqindje për secilin ortak.

Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet si më poshtë :

- **Z. Hamit Aliu**, Me cilësinë e ortakut themelues zotëron një kuotë e barabart me 50 % të vlerës së kapitalit të shoqërisë 50 000 leke (Pesdhjetmijë).
- **Zulfi Osmani** Me cilësinë e ortakut themelues zotëron një kuotë e barabart me 50 % të vlerës së kapitalit të shoqërisë 50 000 leke (Pesdhjetmijë).

Neni 10

Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet me vendim të ortakëve të saj, vendim i cili duhet të depozitohet në zyrën përkatëse. Aktiviteti në këtë shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë të drejtë pronësie dhe aktivitet jashtë kësaj shoqërie.

IV.-ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 11

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj duke u bazuar në këtë Statut dhe në ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 12

Shoqëria kryen veprimtarinë e vet me mjetet e saj financiare, me mjete e kredi të akorduara në mënyrë të ligjshme. Ajo është e detyruar që vëllimin e punës së vet ta ushtrojë në vartësi të shumës së mjeteve të investuara dhe të shumës së mjeteve të rezervuara.

Neni 13

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë të përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së saj.

Neni 14

Kapitali themeltar i shoqërisë dhe kapitali i mëvonshëm mund të krijojë një fond të vecantë, që mund të mbetet në llogarë bankare të shoqërisë. Fondet monetare të shoqërisë do të përdoren në përputhje me këtë statut të shoqërisë dhe ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Shoqëria do të çeli llogari në banke. Ajo do të mbajë llogarë duke u mbështetur në lekun shqiptar, në euro, usd e monedha të tjera të huaja. Veprimet bankare do të kryhen nga ana e ortakëve dhe administratoret e saj.

Neni 16

Shoqëria do të krijojë këto fonde: Fondi Themeltar, Fondi Rezerve, Fondi i Shpërblimit. Për zhvillimin e veprimtarisë së vet shoqëria mund të krijojë edhe fonde të tjera. Fondi themeltar i shoqërisë formohet nga Kapitali Themeltar si dhe mjetet që do krijohen gjatë aktivitetit ekonomik të saj.

Neni 17

Shoqeria shfrytezon fondin Themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interes te realizimit te qellimit te shoqerise, si dhe per te mbuluar rreziqet mbas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin Themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

Neni 18

Fondi Rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohe per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

V.-ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 19

Organet drejtuese te shoqerise:

-Ortaket e shoqerise .

- -Administratori i shoqerise do te jete **Z. Zulfi Osmani**, per nje afat 5 (pese) vjet, Me adrese banimi; Poraj, Tetov, Maqedoni.

Neni 20

Ortaket e shoqerise ushtrojne keto funksione : Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh , ndryshim administrator. Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise, miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e forms se organizimit te shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve. Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per regjistrin tregtar".

Neni 21

Administratori i shoqerise ka keto detyra:

Organizimin e drejtimin e punes dhe veprimtarise se shoqerise, perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivitetin ekonomik te saj. Pergatit aktet qe jane kompetence te ortakeve te shoqerise. Merret me organizimin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, k ualifikimin e punonjesve te shoqerise, perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe nuk jane kompetence te ortakut te vetem.

Neni 22

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes tjetër, qe caktohet nga ai vete me shkrim.

VI.-MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.

Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdorin ate lirisht sipas deshires se vet.

VII.-MARREDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA,

Neni 24

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

Neni 25

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesis e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive e perveses se fituar e shkember ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave, identitetin e shumave e te ardhurave te saj, depozitave, te dhena te tjera qe organizimin e orientimin e shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat e punes qe paraqesin sekretet e punes mund te behen te njohura peronave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marrdhenieve te punes me shoqerine.

VIII.-MBYLLJA E SHOQERISE.

Neni 26

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjetet e ortakeve te kesaj shoqerie, te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likujdimit te shoqerise.

Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise , emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast shperndarje te shoqerise, administratori vendos per menyren e likujdimit, ortaket caktojne nje ose disa likujdator, te cilet bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje detyrimet, qe ka ndaj personave te trete.

Neni 28

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

Neni 29

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 30

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine. Administratori i shoqerise ka te drejte te emeruje avokat dhe ekonomist si dhe t'ju japi te drejta personave te tjere, qe veprojne ne emer dhe per llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

IX.-DISPOZITAT E FUNDIT.

Neni 31

Shoqeria deklarohet e krijuar me vendimin e Ortakeve te shoqerise. Nga kjo dite fiton statusin e Personit Juridik.

Neni 32

Ndryshimet ne kete statut behen ne te njeten menyre e procedure me te cilen nxirret ky statut duhe zbatuar dispozitat ligjore perkatese.

Neni 33

Mosmarreshjet ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor te qytetit ku i takon.

Neni 34

Ky Statut u perpilua ne pese kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES

Hamit Aliu

Zulfi Osmani